



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 12.06.2024 Nr. 61 Regj.Themeltar, ka paraqitur pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar kërkesën me objekt: Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve dhe kriterëve të zbatimit të masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*”, e caktuar me vendimin nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj personit nën hetim **Perlat Canaj**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Çela, me vendimin Nr. 61 datë 14.06.2024, vendosi:
  1. Vazhdimin e zbatimit ndaj personit në hetim **Perlat Canaj**, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” e kryer në bashkëpunim e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, të masës së sigurimit personal “*Arrest në burg*” e parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar me vendimin Nr. 54, datë 06.06.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
  2. Urdhërohet Policia Gjyqësore, që personi nën hetim Perlat Canaj, të dërgohet menjëherë në institucionin e paraburgimit, për të qëndruar aty në dispozicion të organit procedues.
  3. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita njoftimit të vendimit të gjykatës.

**Tiranë, më datë 14.06.2024**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**